



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:253046

Datë: 29.10.2020

Numri i dokumentit: 01228291

P.nr 1013/19

**NE EMER TE POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PEJE** –Departamenti i përgjithshëm me gjyqtari e vetëm gjykues Ahmet Rexhaj , me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lindmire Begolli ,në çështjen penale kundër te pandehurit R.D. nga fsh Nabergjan K-Peje , për shkak te veprës penale ; Falsifikimi i doku mentave nga neni 398 par 1 te KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës se prokurorisë Themelore ne Peje , Departamenti i përgjithshëm PP/II nr 1998/19 te dt. 30.10.2019 pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt 26.10.2020 te mbajtur ne prezencën e te pandehurit R. D. , prokurori i shtetit Arben Hoti e ne mungesë te palës se demtuar , ka marr dhe botërisht ka shpalle këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri**

1.R. D. i lindur me ..... ne fsh .....K- Peje , ku tani me vendbanim ne fsh ..... K- Peje , i biri i Z. , nënës D. e gjinisë B., ka te kryer shkollën mesme , me profesion i pa pune , i martuar baba i 3 fëmijëve gjendjes dobët ekonomike, me numër personal ..... shtetas i Republikës së Kosovës mesme, gjendet në liri,

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me dt ..... ne kohe te pacaktuar ne Peje ,pikërisht ne zyrën e noterit .... me dije përdor dokumentin e falsifikuar me qellim te shfrytëzimit te atij dokumenti si ne orgjinale ne ate menyre qe i pandehuri ne vendin e lartcekur lidhe kontrate shitblerje me personin J. F. ku objekt i kontratës është vetura e markës .... ngjyre ..... me targa ..... me nr te karrocerisë te ..... e cila pas ekspertizës ka rezultuar e falsifikuar pasi qe pllaka metalike ku gjendet i shtypur (stampuar) ky numër i karrocerisë eshte i salduar ne karrocerinë e kësaj veture mbi numrin e me hershme ekzistues dhe si i tille nuk është sipas standardi .... .

Me çka ka kryer vepër penale, Falsifikim i dokumentave nga nei 398 par 1 te KPRK-së

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,43,46,73, të KPK-së, nenit 398 par 1 te KPRK-së të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurit R. D. i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit R. D. i cakton dënim me gjobë në shumë prej 250 € (dyqindpesdhjetë euro) e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit,

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20€ (njëzetë euro), si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€ (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil,

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 1998/19 te dt. 30.10.2019 kundër të pandehurit R. D. nga fshati ..... K-Peje , për shkak të veprës penale: Falsifikim i dokumentave nga nei 398 par 1 te KPRK-së

Gjykata e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestarë me datë 26.10.2020 , pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit së PP/II. nr. 1998/19 te dt. 30.10.2020 , në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzën dhe të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe I pandehuri përgjigjet se i ka kuptuar të gjitha përparësitë benefitet për pranim të fajësisë deklaroj e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem paraprakisht unë në vije të trasha kame qene i njoftuar edhe para kësaj seance për veprën për të cilën akuzohem pa mare parasysh rrethanat që kane ndikuar për të ardhur gjer te ky proces gjyqësorë e ndih veten fajtor kërkoj falje i propozoj gjykatës pranimin e fajësisë te merr si rrethana lehtësues ,

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse i njëjti e ka pranuar fajin duke i kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa ndonjë presion, konsideron se i njëjti pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresë të lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të pandehurit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të pandehurit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lart cekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë : vendimi për ndërprerjen e hetimit kundër të pandehurit J. F. ne drejtim te veprës penale falsifikim i dokumentit nga nrni 398 par 2 te KPRK-s barta ne kompetence nga prokuroria themelore ne Mitrovicë raport i policit V. M. me nr te ID ... i dt 16.02.2019 vertetimi mbi konfiskimin e automjetit .....dhe librezat e qarkullimit me nr serik ..... kontrata mbi shitblerje e automjetit e noterizuar tek Noteri ..... me dt ..... raporti i ekspertimit te veturës me nr ..... intervista e te dyshuarit R. D. e dhene ne stacionin policor ne Peje ne hetimeve rajonale DRP-Peje me dt ... intervista e te dyshuarit F. D. e dt ..... si dhe te shikohen shkresat e tjera te lendes.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vendosur që të pandehurin R. D. ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjyqtari i vetëm gjykues e ka marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, se është penduar për kryerje e kësaj vepre penale, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të pandehurin.

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues, dënimi i shqiptuar me gjobë ndaj të pandehurit R. D. e duke i marrë për bazë rrethanat e lart cekura, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të pandehurit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPRK-së, e obligoi të pandehurin në paguar jen e paushallit gjyqësor.

Konform nenit 463 par 1 dhe 2 palën e dëmtuar e ka udhëzuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike .

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.  
P.nr . 1013/19 te dt 29.10.2020**

**Sekretare juridike**  
Lindmire Begolli

**Gjyqtari**  
Ahmet Rexhaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:253046  
Datë: 29.10.2020  
Numri i dokumentit: 01228291